



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:085768

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05451928

PKR.nr 98/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË –Departamenti i Krimeve të Rënda, në përbërje nga Kryetarja e trupit gjykues – Gjyqtarja Alltën Murseli, anëtarët – gjyqtarët profesionist, Naser Foniqi dhe Gëzim Ademi, me bashkëpunëtoren profesionale Qëndresa Alimehaj- Ujkani, në çështjen penale ndaj të pandehurit J.M për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i Krimeve të Rënda me nr. PP.I.nr 84K/2018 e dt. 28.03.2019, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur më datë 23.01.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorit i Shtetit Bekim Kodraliu, i akuzuari me mbrojtësen e tij Av. Shpresa Hasaj-Hyseni, me datë 26.01.2024 mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me date 01.03.2024 përpiloi këtë ;

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

J.M, nga i ati L., dhe e ëma S. e gjinisë B. i lindur më ... në fsh, ..., komuna e ..., me vendbanim në fsh..., Komuna e ..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: me dt. 08.08.2017, në Prishtinë, në ndërtesën e Policisë e Kosovës , i pandehuri, në cilësinë e personit zyrtar si anëtar i komisionit në tenderin “ F...” me nr. të prokurimit ..., i cili përfaqësonte Drejtorin e Hetimeve kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit ka shfrytëzuar detyrën zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër , në atë mënyrë që në tenderin “F...” i paraparë në vlerë prej 730.000,00 Euro, pasi që komisioni gjatë punës në përbërje nga i pandehuri, S.B dhe N.L , pas kontrollit kishin konstatuar se asnjëri nga Operatorët Ekonomik nga 8 (tetë) sa kishin konkurruar, nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara në tender, atëherë i pandehuri me qëllim që t’i bëj të mundur Operatorit Ekonomik”A...”SH.P.K që të fiton tenderin edhe nuk kishte plotësuar kushtet , me datë 08.08.2017, në ora 12:42, derisa ishte duke qëndruar në një zyre merr çelësin mbi tavolinë në atë mënyrë të kundërligjshme, pa prezencën e anëtarëve të tjerë të komisionit e në kohën e pauzës shkon në zyrën e prokurimit merr paketën e “A...” ndërron mostrat e Rrobave Elegante dhe i vendos mostrat e të tjera të cilat

i kishte sjellë nga jashtë me një çantë krahu edhe pas pak e kthen paketën në zyrën e Prokurimit , i pandehuri kishte vepruar në këtë mënyrë me qëllim që ‘‘A...’’ të fitonte tenderin në mënyrë të kundërligjshme në vlerë prej 506.216.20 Euro,

- me ç’rast ka kryer veprën penal Keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7,17, 21, 38, 42, 47, 59 dhe 422 të KPRK-së dhe 364, 365 të KPPRK-së e:

GJYKON

Të akuzuarin J.M i shqipton **Dënim me Burgim me Kusht** në kohëzgjatje prej **2 (dy) viteve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej **3 (tri) viteve** nuk kryen vepër të re penale, nga dita kur aktgjykimi merr formën e e prerë.

Konform nenit 59 par.1 , nën par.2, pika 2.3 të KPRK-së , i shqipton :

DËNIM PLOTËSUES

Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik , në kohëzgjatje prej **3 (tri) viteve**.

Obligohet i akuzuarit që të i paguaj shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, shumë prej **300 (treqind) Euro**, si dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumë prej **50.00 (pesëdhjetë) Euro**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën, PP.I.nr 84 K/2018 e dt. 28.03.2019 kundër të akuzuarit J.M për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit në Prishtinë me vendimin PAKR.nr .. tëdt 12.12.2022 e ka kthyer çështjen në rigjykim duke e anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me nr. PKR.nr ... të dt. 21.06.2022.

I pandehuri në këtë seancë të shqyrtimit gjyqësor, me rastin e deklarimit të tij rreth fajësisë, u deklarua i pafajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj gjykata në kuptim të nenit 323 të KPPRK-së ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor me radhën e paraqitjes së provave, fjalën hyrëse, prezantimin e provave, mbrojtjen e të pandehurit, si dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ka ardhur në përfundim se gjatë shqyrtimit gjyqësor vetëm se janë fuqizuar edhe më shumë provat e riadministruara ,të cilat vërtetojnë përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I njëjti i është referuar dëshmisë së dëshmitarit N.L , ku ka theksuar se njëjti si në procedurë paraprake po ashtu edhe te dt. 30.05.2023 në shqyrtim gjyqësor dëshmon dhe deklaroi se qëndron pranë deklaratave të lartcekura, duke theksuar se, i njëjti me vendim ishte caktuar

anëtarë i komisionit për vlerësimin e projektit “F...”. Me dt. 08.08.2017, J.M e ka pasur një kërkesë për mua dhe me tha “mbrëmë të shtëpia ime ka ardhur një OE për të diskutuar në lidhje me tenderin që unë jam në komision dhe i kam treguar që rrobat i ke në rregull, mirëpo specifikat teknike nuk janë sipas kërkesës së PK-së dhe ai ka kërkuar nga unë që a ti hjeku rrobat mostra nga objekti i administratës dhe ta bëjë ndërrimin e mostrave me arsyetimin OE i paska thënë se Turku prodhuesi i rrobave elegante ka bërë vetëm gabim teknik dhe specifikat janë të njëjta siq është kërkuar në Projekt. Kjo tregon shumë qartë se i akuzuari kishte planifikuar planin e veprimit të kundërligjshëm qysh herët. Mirëpo, dëshmitar thotë “unë nuk kam pranuar dhe ia kam tërhequr vërejtjen se kjo është vepër penale dhe mendova që ai e kuptoj që nuk duhet ta bënte këtë”. I kemi bërë vlerësimin e mostrave dhe asnjë OE nuk i ka plotësuar kushtet e kërkuara. J. ka pasur atë ditë një çantë me veti gjatë ditës kur ka ardhur në komision, vetëm atë ditë dhe nuk ka pasur ditëve të tjera. Pas dite kur jam kthyer për të filluar kemi shkuar në zyrën ku kemi bërë vlerësimin zakonisht e kam parë që veç dy anëtarët e komisionit e kishin filluar punën do të thotë S.B dhe J.M, pastaj e pash se kishte filluar puna para se të kompletohet komisioni dhe i kishin vendosur letra e vlerësimit në tavolinë dhe thonin se kemi gabuar diçka gjatë vlerësimit të operatorëve edhe kryetarja me ka thënë se e kemi gabuar një OE për te specifikat e ofertave, thanë se e kemi bërë një specifik ndryshe që realisht është ndryshe ku sipas tyre i bie që ne si komision kemi gabuar në vlerësim dhe se i njëjti pasi që kishte parë ndryshimet e bëra e ka ndërprerë punën e tyre dhe ka lajmëruar shefin me qëllim të mos dëmtohet buxheti i Kosovës, vet organizata dhe komisioni. I njëjti i është referuar edhe dëshmisë së dëshmitares S.Z duke pretenduar se nga dëshmia e saj u vërtetua saktësisht vendi dhe koha e veprimit të të pandehurit dhe tregon pikat kryesore shumë qartë se i akuzuari ka kërkuar që të rrinë në zyre ditën kritike dhe e kemi lejuar dhe aty ka qenë çelësi i zyrës ku kanë qenë të vendosura paketat me Operator Ekonomik. Po ashtu tregon se si Jetoni ka kërkuar që të kontrollohet Operatori nr.... “A...” kinse kemi gabuar. Po ashtu tregon se si asnjëherë nuk ka ndodhur që ndonjëri të kërkon që të rrijë në zyre gjatë pauzës nga ndonjë njësi tjetër. Dëshmitari B.H, zyrtar i IPK-se dhe hartues i kallëzimit penal, e po ashtu edhe si zyrtar që kishte hetuar dhe mbledhur provat materiale, siq ishin Video materialet nga zyra ku i akuzuari J.M i kishte ndërmarr veprimet inkriminues, i njëjti gjate shqyrtimit gjyqësor, ndër të tjerash ka deklaruar se “*gjatë hetimit të rastit kemi vërejtur se në zyrën e vlerësimit te tenderit kishte pasur kamera, dhe me atë rast kemi kërkuar nga Major G.F që të na i siguron video incizimet e tilla*”. Të gjitha veprimet i kemi ndërmarr ne konsultim me Kryeprokurorin e atëhershëm I. B dhe zv. e tij I.B . Incizimet i kemi marr nga hetuesia të Policisë duke u mbështetur ne nenin 19 te Ligjit për IPK-në, ku pika 7 thekson se “*IPK ka të dejtë të kontrolloj, konfiskoj, analizoj dhe të mbaj dokumente, dëshmi dhe informacione në formë të shkruar ose elektronike nga të gjitha zyrat, sekretarit, arkivat apo çfarë do burimi tjetër i informacioni në pajtim me ligjin në fuqi*”. Dëshmitari, sa i përket bazës ligjore për marrjen e video materialeve, i referohet edhe një Memorandumi të Bashkëpunimit mes IPK-së dhe Policisë së Kosovës ku nder te tjerash parashihet që IPK-së i lejohet të ketë qasje në të gjitha dokumentet, objektet, arkivat e Policisë së Kosovës. Gjithashu dëshmitari I.K, IT pranë Policisë së Kosovës, i cili po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor ka provuar se incizimet e marra nga IPK-ja janë marrë në mënyrë të ligjshme.. Dëshmitari V.M, pronari i operatorit “A...”, mostrat e të i cilit ishin ndërruar nga i pandehuri M., i njëjtit gjatë dhënies së dëshmisë së tij vërtetoj faktin se Mostrat të cilat i kishte zëvendësuar i pandehuri M. Prokurori i shtetit gjithashtu në fjalën përfundimtare ka pretenduar se edhe me prova materiale është vërtetuar se i pandehuri J.M ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, duke i elaboruar me rradhe secilën veç e veç. Sa i përket video-incizimeve ka theksuar se janë marrë në mënyrë

të ligjshme sepse janë dorëzuar nga vet Policia e Kosovës në IPK dhe janë marrë në mënyrë të ligjshme sepse janë dorëzuar nga vet Policia e Kosovës në IPK dhe sipas Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, IPK-ja ka të drejtë të tërheq prova nga çdo objekt i Policisë së Kosovës, respektivisht kamerat janë vende publike e jo private. Këto video incizime janë dorëzuar nga Shefi i Departamentit G.F me shkresën zyrtare kur është lajmëruar rasti me datë 15.08.2017 e që është pjesë e shkresave të lëndës, gjendja faktike vërtetohet edhe nga Raporti i Ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzik AKF-.... Gjithashtu ka theksuar se i pandehuri gjatë intervistimit në IPK ka pranuar se ditën kritike me datë 08.08.2017, gjatë kohës së pauzës ka qëndruar i vetëm në zyre të zyrtarëve të Prokurimit. Prokurori i shtetit gjithashtu në këtë fjalë përfundimtare ka sugjeruar që gjykata dhe një herë të shqyrtoni provat e administruara sipas sugjerimeve të gjykatës së Apelit në veçanti dëshminë e dëshmitarit N.L si dëshmitar kyç. Andaj, Prokurori i shtetit konsideron se ka ofruar prova bindëse dhe të ligjshme që dëshmojnë se i akuzuari J.M e ka kryer veprën penale dhe është përgjegjës për veprimet e kryera të kundërligjshme dhe janë përmbushur të gjitha elementet nga vepra penale *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar* nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së, suke kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas kodit penal duke marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rendues si dhe gjithashtu të njëjtit ti shqiptohet dënimi plotësues “*Ndalimi i ushtrimit të funksionit në administrata publike ose shërbim publikë*”.

Mbrojtësja e të pandehurit J.M, Av. Shpresa Hasaj Hyseni në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Nuk është provuar se i pandehuri J.M ka kryer veprën penale i cila i vihet në barrë, e njëjta i është referuar dëshmitarëve të dëshmitarëve nga të cilat konsideron se nuk vërtetojnë faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale. Nga dëshmia e dëshmitares S.B, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ka qenë pjesë e tenderit për “F...” madje ka qenë kryetare e komisionit. E njëjta ka deklaruar se nuk ka mundësi të ndërrohet rrobat sepse çdo gjë ka qenë nën vëzhgimin e kamerave dhe si komision kanë të drejtë 100 herë ti shiqojnë specifikat e materialet dhe mendimin përfundimtar e marrin së bashku si komision e që në këtë moment ende nuk kishin arritur në vlerësimin e tenderit por te nënvizimi i specifikave që pastaj duhet ti vendosin në vlerësimin përfundimtar dhe sigurisht edhe në tendere tjera ka pasur këso lloj gabime dhe përmisime, por ka ndodhur në raste që ka ndryshuar përmbajtjen në tiketate e rrobave, përkatësisht në jakë ka qenë ndryshe, ndërsa në dorë ka qenë ndryshe. Gjatë vlerësimit të specifikave herën e parë është bërë përshkrimi 70/10/20, ndërsa herën e dytë regjistrimi 70-20-10, që është përmisuar. Vlerësimi përfundimtar edhe pse nënshkruhet nga tre anëtar të komisionit të vlerësimit në përfundim e nënshkruan edhe drejtori ose e refuzon ta nënshkruaj. Kryetarja e komisionit ka theksuar se nuk ka parë ndonjë veprim të kundërligjshëm të J.M në këtë proces. Gjithashtu dëshmitari N.L i cili ka qenë anëtar i komisionit ka deklaruar se dëmi nuk është shkaktuar dhe si komision kanë vlerësuar se asnjëri nga operatorët ofertues nuk i kanë plotësuar kriteret meqenëse kanë qenë kritere të caktuara me specifika të veçanta. Ka pohuar se i tërë objekti policisë është i mbuluar me kamera dhe siç thot dëshmitari “ unë nuk i kam parë kamerat por eprori G.F ka dasht me verifiku se a janë në atë objekt, besoj se i ka shikuar dhe verifikuar për atë që ka ndodhur”. I njëjti ka deklaruar se nuk e di se përse është anuluar tenderi dhe se nuk e ka parë asnjëherë të pandehurin Jeton duke i ndërruar mostrat. Dëshmitari E.Hka deklaruar se nuk i kujtohet se në zyrën e prokurimit ka qëndruar J.M, gjatë pauzës ditën kur pretendon se janë ndërruar mostrat e rrobave. Dëshmitari B.H i cili punon në IPK thekson se nuk ka pasur urdhër nga prokurori apo gjykata për nxjerrjen e incizimeve sepse me këtë rast janë marrë Policia e Kosovës dhe ata i kanë nxjerrë incizimet, por e din që vendi ku janë bërë kontrollimet e mostrave kanë qenë nën monitorim të kamerave. Dëshmitari I.K i cili ka punuar si administrator në sistemin e kamerave të Policisë së Kosovës ka deklaruar se ka pranuar një kërkesë verbale e jo me shkrim, për nxjerrjen e video incizimeve. Andaj, mbrojtësja e të

pandehurit ka pretenduar se më asnjë provë nuk vërtetohet se i mbrojturi i saj J.M ka kryer veprën penale sepse aktgjykimi nuk mund të mbështetet në prova të pa pranueshme dhe asnjë nga dëshmitarët nuk kanë thënë se e kanë parë J. duke i ndërruar mostrat e rrobave të tenderit. Sipas asaj që kemi gjetur në shkresa të lëndës dhe sipas njoftimit për anulimin e prokurimit , rezulton se tenderi nuk është anuluar për atë që është pretenduar në aktakuzë fare, por sepse nuk i ka përmbushur kushtet e tenderit. Nuk është shkaktuar asnjë pasojë dhe nuk ka përfituar “ A...” nga ky tender, buxheti i Republikës së Kosovës nuk është dëmtuar për asnjë moment nga askush. Andaj nga e gjithë përmbledhja e fjalës përfundimtare mbrojtja e të pandehurit konsideron se nga gjithë kjo procedurë e zhvilluar – rigjykimit që nga dita e parë e pretendimit të ndodhjes së rastit , nuk është dëshmuar dhe nuk është vërtetuar se J.M ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka kërkuar nga gjykata që të merr aktgjykim lirues konform nenit 346 të KPPRK-së.

I pandehuri J.M në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtjes sime. Është vërtetuar në mënyrë të sakt se mostrat- rrobat elegante për të cilat vazhdimisht më ka akuzuar prokuroria se unë i kam marrë kinse të njëjtat, dëshmitari deklaroi se i ka dorëzuar dhe i ka tërhequr të njëjtat , ashtu që ka kërkuar nga trupi gjykues që i njëjti të lirohet nga aktakuza.

Gjykata për vëretimin e plotë të gjendjes faktike në këtë çështje penale juridike, në kuptim të nenit 7 dhe 361 të KPPRK-së ka bërë administrimin e provave personale dhe materiale, ka dëgjuar dëshmitarët S.B, N.L, E.H, B.H, I.K dhe V.M si dhe provat materiale: Dosja e tenderit për kontratë publike kornizë- Furnizimi e dt...., Vendimi mbi caktimin e anëtarit të komisionit i dt...., Transkripta nga videoincizimi i Dy CD incizimet nga kamerat e sigurisë, Shkresa, Aneksi 1, Specifikimet Teknike të Detyrueshme, Shkresë e punës së komisionit OE “ A...” , Raporti i Ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë ... të dt. ..., Njoftimi për anulimin e aktivitetit të Prokurimit nr. ... i dt. ...

Dëshmitarja S.B në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se qëndron pranë deklaratave të dhëna në shqyrtim gjyqësor të dt. 02.09.2021 dhe të dt. 05.10.2021, e cila ka deklaruar se me datë 02.08.2017 është caktuar Kryetare e Komisionit për vlerësimin e projektit “F...”, e njëjta ka thkesuar se J. atë ditë ka pasur një qantë me vete dhe kur ka hyrë e ka lënë në karrikë në qosh pas derës. Pas pauzës ka ardhur J. dhe më ka kërkuar ti rishikojmë edhe një herë mostrat e operatorëve ekonomik me arsyetimin se kemi mundur të bëjmë ndonjë gabim gjatë leximit, pastaj duke i besuar J.t nën vëzhgimin e kamerave e ka hapur kutin që ka qenë më afër dhe e ka lexuar përmbajtjen e operatorit ekonomik numër ... , duke theksuar se ne kemi shkuar së bashku e kemi hapur paketën e këtij operatori dhe duke e parë që kemi mundur të gabojmë unë e përmisova me kimik vlerësimin e mëparshëm. E njëjta këto deklarime i ka konfirmuar edhe në shqyrtimin gjyqësor të dt 26.04.2023 ka deklaruar se Kompania “ A...” në fillim nuk ka plotësuar specifikat teknike, pastaj z. J. një ditë ka ardhur e ku data nuk më kujtohet, më ka kërkuar që të hy edhe një herë të kontrolloj rrobat e operatorit ekonomik A...dhe të operatorëve tjerë dhe kemi hyrë së bashku kemi kontrolluar, pastaj nuk më kujtohet se cilën dite në vazhdim, kemi hyrë me tani të akuzuarin dhe kemi bërë kontrollin. Kemi hyrë nën vëzhgim të kamerave, kemi hyrë edhe një herë për te kontrolluar rrobat aty ku kanë qenë të vendosura, para derës ishin rrobat e Operatorit Ekonomik nr. ... ashtu siç kërkoj të i kontrolloj i akuzuari, duke i kontrolluar e kem vërejtur se përmbajta ishte ndryshe dhe specifikat ishin ndryshe, në specifikat të cilat kanë qenë të paraqitura në specifikacione e vërejtëm se nga sakoja pantollonat që ka qenë, ka qenë ndryshe përshkrimi. Kam menduar se gabimisht është shënuar 10-20 dhe veç është ndërruar e polisterit dhe viskozës ndërsa wool ka qenë mire, të cilin e ka pasur secili operator, e pastaj është përmisuar me kimik të thjeshtë, viskoza polister në përqindje dhe në përmbajta. Përmbajta e

rrobave ka qenë wool, viskoze dhe polister, herën e parë kur kemi bërë përshkrimin ka qenë 70% 10% 20% ndërsa herën e dytë e kemi regjistruar 70% 20% 10% , sa më kujtohet leximin dhe përshkrimin e ka bërë J.M ndërsa unë kam shënuar me një letër të thjeshtë me kimik, gjithashtu edhe në herën e dytë është bërë ngjashëm. Unë kam thënë në deklaratë edhe me herët shumë qartë, ndoshta kam menduar se kemi gabuar për shkak të renditjes që ka qenë, ndërsa z.M. ka hyrë dhe rrobat i ka marrë jashtë dhe aty kam parë se nuk ka qenë gabim, ka hyrë nën vëzhgimin e kamerave dhe me vonë kemi vërejtur se nuk paskemi qenë gabim, pasi që kemi parë në media se si ka hyrë në kohë pauze dhe i ka tërhequr mostrat jashtë. E njëjta ka dëshmuar se kemi qenë duke përmisuar këto të dhëna, kur ka ardhur anëtari i komisionit N.L dhe ka hyrë brenda, na ka thënë çfarë po bëni, unë i thash se është lexuar gabimisht polister dhe viskoza, dhe i treguam që e bëmë permisim në një letër të thjeshtë me kimik, ndërsa ai zotëriu na tha, a bën me thirrë drejtorin, pse e keni bërë këtë permisim, mirëpo ai e kishte ditur që Z.M. ka pas për të hyrë me i ndërru sepse e kishte njoftuar paraprakisht z. L. me arsyetimin se prodhuesi e ka vendosur gabimisht përqindjen e materialit, atëherë është larguar N.L dhe e kemi thirrur drejtorin, zëvendës drejtorinë e prokurimit E.H i cili është zyrtar i prokurimit, që ende punoj me të në një zyre, e thirra dhe i tregova se z.L. po thotë se janë ndërruar rrobat, por unë i thash se nuk kanë mundur të ndërrohen, pasi kanë qenë nën vëzhgimin e kamerave, edhe zëvendës drejtori u çudit, me fjalët e z.L. Unë i kam parë zëvendës drejtorin z.E.H dhe anëtarët e komisionit të cilët e kanë marrë Cd e inqizimit. Për të mos e zvarritur lëndën , për të mos shkuar në OSHP ne kemi të drejtë 100 herë ti shohim specifikat materialit, por mendimin përfundimtar e marr se bashku si anëtarët e komisionit ,kur bëhet vlerësimi për tenderim e në rastin konkret akoma nuk kemi arritur tek vlerësimi, por tek nënvizimi i specifikave të cilat më pastaj duhej të vendosnim në vlerësim përfundimtar. Sigurisht edhe në tendere tjera ka pasur këso lloje gabime dhe përmisime, por ka ndodhur me raste e kanë ndryshuar përmbajtjen në tiketa e rrobave, përkatësisht në jakë ka qenë ndryshe, ndërsa në dorë ka qenë ndryshe, dhe operatorët e tillë janë njoftuar tek organet kompetente. Me tani të akuzuarin dhe z.Lahu kemi qenë në komision vetëm për këtë tender dhe me herët nuk kam i kam njohur te njëjtë, kam pasur raporte kolegjiale, e ndërsa nuk kam vërejtur që z.M dhe z.L kanë pasur ndonjë jo të mirë mes veti.

Dëshmitari N.L në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ka marrë pjesë në komision për vlerësim të projektit ‘Furnizimin me rroba elegante’ me nr. të prokurimit ..., duke sqaruar se ka qenë anëtar i komisionit (toger), kryetare e komisionit ka qenë S.B, ndërsa anëtari tjetër J.M (rreshter).I njëjti ka deklaruar se i përmbahet në tërësi deklaratës së dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë 18.11.2022, i cili kishte deklaruar se me dt. 02.08.2017 kam filluar punën në komision, jam caktuar si anëtar i komisionit, detyrë e komisionit ka qenë vlerësimi i operatorëve ekonomik (OE). Ditën e parë të punës e kemi filluar duke e bërë një plan si të bëhet vlerësimi për arsye se për mua ka qenë hera e parë Për secilin operator e kemi printuar nga një kopje fizike dhe kemi filluar vlerësimin se a i plotëson kriteret sipas kërkesit- Policisë së Kosovës, për secilin operator kemi shkuar një nga një dhe kemi evidentuar se a e i plotëson kriteret apo nuk i plotëson kriteret. Vlerësimi është bërë në objektin e policisë, në një zyre ku ka pasur edhe kamera e cila është zyre e posaçme për vlerësimin e OE. Mostrat që kanë qenë për tender kanë qëndruar gjatë gjithë kohës kanë qenë në zyrën me kamera, përveç në rast kur ne kemi shkuar i kemi marrë mostrat dhe kemi bërë vlerësimin, dhe përsëri i kemi kthyer në të njëjtin vend. Vlerësimet zakonisht brenda ditës i kemi përmbyllur, ka pasur një operator ekonomik që i ka pasur 5-6 artikuj, dhe saktësisht nuk e di se sa kohë ka marrë, por zakonisht brenda ditës i kemi përmbyllur me operatorët ekonomik, ashtu siç e kemi hapur edhe e kemi mbyllur. Operatorët Ekonomik pjesërisht në disa pika i kanë plotësuar por me sa më kujtohet asnjë Operator Ekonomik nuk i ka plotësuar kriteret. Me datë 08.08.2017 rreshteri J. e ka pasur një kërkesë për mua, pasi që kemi dalur jashtë objektit në vendin ku pihet cigarja dhe më ka thënë ‘ka qenë një OE mbrëmë tek shtëpia ime dhe i kam

treguar se specifikat nuk janë sipas kërkesës së policisë dhe operatori më ka thënë se është vetëm një gabim teknik prej prodhuesit dhe duhet të ndërrohen mostrat'', mirëpo unë nuk kam pranuar, i thash se kjo është shkelje ligjore dhe se e rrezikon punë dhe ki pasoja ligjore. dhe i njëjti e ka kuptuar se është e kuartë e kuptova ashtu është deklaruar dhe kemi vazhduar. Më ka thënë edhe emrin e operatorit ekonomik, por tani nuk më kujtohet. Vlerësimin kur e kemi bërë si komision që me qenë më transparent e kemi nxjerrë nga një kompani të OE me nr. për të mos u ditur se për cilin OE bëhet fjalë. Jetoni atë ditë ka pasur një çantë ke qenë dy krahëshe e cila ka qenë e madhe, çanta ka qenë e vendosur afër meje në të njëjtin vend ku e kemi bërë vlerësimin si komision, ka qenë në tokë. Atë ditë kemi punuar paradite, e pazakontë për mua ka qenë çanta prezent, pse çanta aty dhe rreshteri më ka thënë se i kam sjellë për ta rregulluar se e ka një defekt. E pa zakonta e asaj dite ka qenë që kur kemi filluar, asnjëherë komisioni nuk ka filluar pa qenë komplet anëtarët e atë ditë kam shkuar në kohën kur është caktuar nga kryetarja e komisionit, data nuk më kujtohet, shtoj se pjesën e paradites kemi filluar me kohë që të tre. Ne anëtarët e komisionit e kemi bërë vlerësimin, kur kemi filluar nuk më kujtohet ora, por vlerësimin e kemi bërë deri në ora 11-11:30, dhe pastaj kemi dal për drekë. Pasdite kur jam kthyer për të filluar kemi shkuar në zyrën ku kemi bërë vlerësimin zakonisht, e kam parë që dy anëtarët e komisionit e kishin filluar punën do të thotë S.B dhe J.M, pastaj e pash se kishte filluar puna para se të kompletohet komisioni dhe i kishin vendosur letra e vlerësimit në tavolinë dhe thonin se kemi gabuar diçka gjatë vlerësimit të operatorëve, nuk më kujtohet saktësisht se cili më ka thënë por në një moment më ka thënë edhe kryetarja se e kemi gabuar një OE për te specifikat e ofertave, pastaj unë pyetjen e para që e bëra ishte pse ka filluar komisioni pa u kompletuar që asnjë herë më parë nuk ka ndodh, kur pyeta se çka kemi gabuar më thanë se kemi gabuar tek një OE emri i të cilit nuk më kujtohet, thanë se e kemi bërë një specifik ndryshe e që realisht është ndryshe ku sipas tyre i bie që ne si komision kemi gabuar në vlerësim. Mirëpo unë i pash se kishin filluar ti bëjnë ndryshimet nëpër fletat e vlerësimit që zakonisht i ka mbajt kryetarja, e këtu unë e kam ndal situatën ju kam thënë se këtu diçka nuk është në rregull, qëllimi im ka qenë mos me u dëmtua buxheti i R. Kosovës dhe mos me ndodh ndonjë vepër penale, sepse nëse ne lejojmë që të ndryshohet ndonjë mostër nga dikush pa i plotësuar kriteret dëmtohet vet organizata, buxheti dhe komisioni si komision. Pastaj, e kam ndaluar punën dhe kam thënë se kjo nuk është në rregull. Situata filloi të tensionohet, reagimi i J. ishte shumë i ashpër, ka kërkuar që mos të bëhet e madhe kjo punë prej meje personalisht se këtë punë nuk e din askush përveç meje (J.), teje (N.) dhe E.H. Kam kërkuar nga kryetarja që këto që kemi punuar deri në momentin e caktuar të i printoj dhe të mi jap kopjet e punës që e kemi bërë deri në atë moment dhe i kam marr kopjet ku këta kanë bërë përmirësime. Jetoni ka thënë se gjithçka që ndodhë unë e marr përgjegjësinë vet. Pastaj, i kam marr kopjet, fletët e vlerësimit i kam kompletuar dhe ju kam thënë se do ti njoftoj eprorët e lartë dhe në këtë rast drejtor ka qenë G.F. Para përfundimit të orarit i kemi mbyllur paketat, unë u kam thënë se do të bëj një raport të detajuar për eprorët dhe do të tërhiqem nga ky komision për shkak të pa rregullësive, të njëjtën ditë kam vazhduar dhe e kam bërë raportin dhe të nesërmen në mëngjes jam takuar me G.F të cilit ia kam dorëzuar raportin. Emri i operatorit të cilit i janë bërë ndryshimet nuk më kujtohet, por fjala është për të njëjtin operator për të cilin janë prekur mostrat. Ndërsa ka deklaruar se nuk kanë arritur të finalizojnë vlerësimin sepse i njëjti është tërhekur nga komisioni dhe nuk e di arsyen e anulimit të tenderit. Të njëjtat deklarime i ka konfirmuar edhe në shqyrtim gjyqësor të dt 30.05.2023 në pyetjet e parashtruara nga anëtari i trupit gjykues – gjyqtari Naser Foniqi.

Dëshmitari E.H në shqyrtim gjyqësor të 14.12.2021 dhe në shqyrtim gjyqësor të dt.30.05.2017 ka deklaruar se në vitin 2017 ka qenë në pozitën e zyrtarit të lartë të prokurimit dhe se e ka zëvendësuar drejtorin e prokurimit kur nuk ka qenë në punë, në ndonjë pushim apo udhëtim zyrtar. Në kohën kur është bërë hapja e tenderit për "F..." i njëjti ka deklaruar se e ka zëvendësuar drejtorin, pasi që drejtori ka qenë në pushim vjetor, gjatë kohës kur është hapur

tenderi dhe kur ka filluar vlerësimi i ofertave nuk ka pasur ndonjë rol. Në shqyrtimin gjyqësor të dt. 14.12.2021 se lidhur me tenderin për ‘Furnizim me rroba elegante’ ka deklaruar se është formuar komisioni në përbërje nga S.B, N.L dhe J.M. I njëjti ka deklaruar se deri në një ditë kur jam ftuar nga zyrtari i prokurimit , kam hy në zyrën e kamerave ku ka qenë komisioni dhe kam pasur një shqetësim se ka mundur të ndodhë ndërrimi i disa mostrave. Anëtarët e komisionit fillimisht punën e kanë kryer në zyrën e kamerave e pastaj kanë kërkuar që të vlerësojnë në zyre tjetër të prokurimit pasi që në atë zyre nuk ishin kushtet e mira dhe ishte shumë vapë, më kanë kërkuar që të vazhdojnë në zyrën nr... ku punon kolegja S.B dhe unë, mirëpo unë atë ditë kam qenë në zyrën e drejtorit të prokurimit sepse isha duke e zëvendësuar atë. Më tutje ka theksuar se nuk i kujtohet se nëse J.M ka qëndruar në zyrën e prokurimit gjatë pauzës.

Dëshmitari B.H në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se në IPK punoj që 11 vite dhe kam mbajtur pozita të ndryshme duke filluar si hetuesi në departamentin regjional, inspektor në departamentin e inspektiveve, së fundi hetues në Divizionin e Inteligjencës dhe informacioneve në kuadër të departamentit.

Në vitin 2017 unë kam punuar si hetues në Divizionin e Prishtinës në kuadër të departamentit të krimeve, më kujtohet se unë kam qenë hetuesi i parë i kësaj lënde kur është iniciuar nga Polica e Kosovës dhe jam ngarkuar nga shefi im D.B. Incizimet kanë qenë të nxjerra vetëm nga Policia e Kosovës, dhe pasi që ata kanë shikuar dhe kanë vlerësuar se ka elemente për dyshim për vepër penale e kanë inicuar rastin në Inspektorat Policor të Kosovës. Rasti është iniciuar në bazë të atyre video incizimet dhe dëshmitarëve të cilët kanë raportuar rastin, me sa më kujtohet ka qenë me gradën toger raportuese i rastit. Sa më kujtohet pas analizimit të shkresave të pranuar nga policia e Kosovës në ato shkresa dhe në ato raporte të zyrtarëve policor kanë qenë të cekura kryesisht në raportin e drejtorit të departamentit - nënkolonel G.F, ku inicues i rastit ka qenë ai. Në ato shkresa është cekur që ata kanë pare video incizimet të cilat kanë qenë të vendosura nga Polica e Kosovës në zyrat për vlerësimin të dosjeve të tenderit, po ashtu edhe të kësaj dosje. Këto incizime i kemi marrë në bazë të Ligjit me të cilin funksionojmë, Ligji i IPK-së, neni 19, pika 7 ku përcakton ‘**IPK ka të drejtë të kontrolloj, konfiskoj, analizoj dhe të mbaj dokumente, dëshmi dhe informacione në formë të shkruar ose elektronike nga të gjitha zyrat , sekretariti, arkivat apo çfarëdo burimi tjetër në pajtim me ligjin në fuqi**’ dhe pasi që incizimet kanë qenë të nxjerra nga Policia e Kosovës, me urdhëresë të Prokurorit të shtetit I.B, i kemi dërguar për ekzaminim në Agjencion të Forenzikës së Kosovës.

Incizimet i kemi marrë në formë të CD , sa më kujtohet kanë qenë 2 CD, ashtu me sa kujtohet i kam marrë në zarf dhe i kam dërguar në Forenzikë pas urdhërit nga prokurori ,pastaj është pranuar një raport me sa më kujtohet dhe çdo herë bëhet një raporte për tërheqjen nga Forenzika, por unë nuk e kam parë këtë raport sepse nuk kam qenë më i ngarkuar me këtë lëndë. Lëndët të cilat kam qenë i ngarkuar i kam dorëzuar tek shefi im D.B. Hetuesit e tjerë kanë qenë ata të cilët janë marrë me dëshmitarët dhe intervistat dhe analizimin e provave, unë kam qenë i ngarkuar në këtë rast kur janë marrë vetëm CD dhe kur janë dorëzuar të njëjtat në Forenzikë, pastaj e kanë marrë rastin koleg tjerë. I njëjti ka theksuar se përveç Ligjit të lartcekur që lejon IPK-në- të ketë qasje në të gjitha dokumentet, objektet, arkivat e Polices së Kosovës është një marrëveshje bashkëpunim e nënshkruare mes IPK-së dhe Policisë së Kosovës, marrëveshje e datës 10.10.2016 ku në këtë marrëveshje janë përfshirë shumë pika për të cilat i lejohet IPK-së, të përdor mjete e policisë, armatimin e policisë, mjete e masave të fshehta, shfrytëzimin e njësive të specializuare etj, të cilat janë të përfshira në këtë marrëveshje.

Dëshmitari I.K ka deklaruar në shqyrtim gjyqësor se në Policinë e Kosovës punon që 10 vite, se aty punon si staf civil dhe nuk jam zyrtar policor, jam punësuar si administrator i sistemit të kamerave në Policinë e Kosovës në kuadër të drejtorisë të teknologjisë informative.

Si administrator i kamerave në Policinë e Kosovës së bashku me kolegët jemi përgjegjës për administrimin, menaxhimin, instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha sistemeve të kamereve në kuadër të Policisë së Kosovës, ne po ashtu bëjmë edhe nxjerrjen e video incizimeve kur ato na kërkohen. Kërkesat për nxjerrjen e video incizimeve kryesisht drejtohen tek ne dhe pothuajse vetëm ne kemi qasje në nxjerrjen e video incizimeve nga kamerat.

Në bazë të praktikave të deritanishme tani edhe në PSO, zyrtarët përkatës në Drejtorinë Informative e kanë për detyrë nxjerrjen e video incizimeve nga sistemi i kamerave dhe ne ju përgjigjemi kërkesave për nxjerrjen e incizimeve nga hetuesit e IPK-së apo hetuesisë së brendshme të cilat mund të vijnë direkt tek ne apo përmes eprorëve, e pastaj na vijnë kërkesat me shkrim ose email dhe sapo e realizojmë kërkesën.

Në të gjitha rastet ceket arsyeja e marrjes së video incizimit, ceket për shembull nr. i rastit të hetimit ose IPK-së i dërgon numrin e rastit, urdhërat e gjykatës, ndonjëherë i bashkëngjitet kërkesës urdhëri i gjykatës ndonjëherë jo, vlen të ceket për hetim të brendshëm, se në rast që ekziston nevoja e hetimit të ndonjë rasti për hetim të brendshme për ato raste nuk ka urdhër të gjykatës. Video incizimet nga sistemi i kamerave ne i nxjerrim vetëm kur na bëhet kërkesë me shkrim nga hetuesi për ndonjë rast të caktuar. Për rastin që ka ndodhur në muajin Gusht, në vitin 2017 kam pranuar kërkesë verbale nga Drejtori i Departamenti për Shërbime Mbështetëse që ne atë kohë ka qenë G.F, me është kërkuar nxjerrja e video incizimeve për rastin në fjalë, por nuk kam pasur ndonjë kërkesë me shkrim d.m.th. unë kam nxjerre video incizimeve ne rastin në fjalë, saktësisht data nuk më kujtohet por e di që ka qenë dikur rreth 11.08.2017, këto incizime janë barture në një hardisk Medium hardisk për incizime dhe janë dorëzuar tek drejtori në Departamenti për shërbime mbështetëse me tutje ai është marre me video incizimet dhe me rastin në fjalë. Incizimet kanë qenë lidhur me një rast që ka ndodhur në zyrën e prokurimit. Zakonisht kërkesa për incizimet tek ne bëhen në formë të shkruar në email nga IPK, ose nga ndonjë hetues apo varësisht prej rasti se kush e kërkon. I njëjti ka deklaruar se edhe unë kam qenë CC në email kur janë kërkuare video incizimet dikur rreth datës 11.08.2017, kjo kërkesë ka ardhur tek ne, por nuk ka ardhur në mënyrë të zakonshme qysh vijnë kërkesa te na zakonisht kur vie tek ne kërkesa nuk përfshihet për drejtorin e departamentit për shërbime mbështetëse, por kërkesa vjen drejtpërdrejtë tek ne ose nepërmes drejtorit të drejtorisë së teknologjisë informative. Në këtë rast ne nuk kemi pasur kërkesë eksplicite të drejtpërdrejt për nxjerrjen e video incizimeve, lidhur me kërkesën e parashtruar nga Granit Fetahu për marrjen e videoincizimeve kanë qenë të njoftuar eprorët tonë.

Në bazë të emailit shihet se G.F, ka pasur komunikimi me hetuesin e IPK-së Bekim Hoxha, në një korrespondencë me date 09.10.2017, G.F i është drejtuar përmes korrespondencës hetuesit të IPK-së B.H se *“B.. inqizimet e rastit i kërkon nga G.K drejtori IT-se nëse unë nuk jam këtu “* drejtori këtë e ka përcjell tek shefi i sektorit të IT në atë kohë i cili ka qenë F.R meqenëse unë në këtë datë kam qenë në pushim, shefi i sektorit këtë kërkesë e ka përcjellur tek ish kolegu – K.Ç d.m.th. ai e ka realizuar këtë kërkesë. Sa i përket incizimeve me është kërkuare nxjerrja e incizimeve vetëm nga kamerat e sigurisë që gjenden brenda zyrës së prokurimit ku bëhet vlerësimin i ofertave dhe ekzaminimi i mostrave.

Dëshmitari V.M në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se jam pronar i firmës ‘A...’ mirëpo tani firma është passive. Në vitin 2016-2017 kam aplikuar për tenderin për rroba elegante në Policinë e Kosovës, nuk e kam njohur askënd nga komisioni, ndërsa sa i përket procedurës së tenderimit kam pasur njohuri lidhur me aplikim sepse kam marrë pjesë në tendere të ndryshme në Policinë e Kosovës. Mostrat të cilat i kam dorëzuar së bashku me aplikacion, kanë qenë rroba elegante por a ka qenë të mbështjella nuk më kujtohet. Sa i përket S.B dhe J.M nuk i njoh, vetëm përmes komunikimit me email me ata dhe zyrtarët e tjerë të prokurimit i njoh vetëm përmes email që e kam bërë për shkak të dorëzimit të ndonjë mostre apo plotësim të dokumentacionit. Pas dorëzimit të aplikacionit- ofertës, nuk më kujtohet saktësisht, pas një muaj apo dy kam marrë përgjigje ku

më kanë njoftuar Policia e Kosovës se tenderi në këtë rast nuk ka qenë i suksesshëm dhe më kanë ftuar për të i tërhequr mostrat të cilat i kemi dërguar, sepse na kanë njoftuar me email që ti tërheqim mostrat për shkak se tenderi nuk ka qenë i suksesshëm. Mostrat të cilat i kam tërhequr kanë qenë të njëjta me ato të cilat i kam dorëzuar me aplikacion.

Provat materiale të administruara:

Nga Dosja e tenderit për kontratë publike- kornizë Furnizim e dt.14.06.2017, nga e cila vërtetohen kushtet dhe specifikat teknike të detyrueshme të kontratës, cmimi ofertues nga OE “A...” dhe dokumenacioni plotësues.

Nga Vendimi mbi caktimin e anëtarit të komisionit i dt. 02.08.2017 vërtetohet se pjesë e komisionit për tender “Furnizim me rroba Elegante” me nr. të prokurimit ... kanë qenë S.B kryetare e komisionit, i pandehuri J.M është caktuar anëtar dhe N.L anëtar.

Transkripta nga video incizimi i dy cd – incizimet e kamerave të sigurisë shihet mnga videoincizimi Chanel..._ të dt 08.08.2018, në kohën e pauzës se i pandehuri J.M me datë 08.08.2017 në ora 12:42:00 ka shkuar në zyrën e prokurimit, saktësisht tek zyra e kamerave ka tërhequr dy paketa dhe prap në ora 12:43:20 të njëjtat i ka kthyer në zyrën e kamerave. Kurse në incizimin Chanel ..., në ora 13:28:30 në zyrën ku kanë qenë mostrat, kanë hyrë kryetarja e komisionit S.B se bashku me të pandehurin J.M dhe kontrollojnë paketën e njëjtë të cilën Jetoni e kishte nxjerrë nga zyra dhe njëherit bëjnë përmisimin. Video incizime të cilat janë marrë sipas Ligjit për Inspektoratin Policor.

Nga Shkresa , Aneksi 1, Specifikimet teknike të detyrueshme nga kjo vërtetohet se edhe pse komisioni në përbërje të plotë, disa ditë më heret kishte konstatuar se OE “A...” nuk i plotëson kushtet e specifikuar në pikën 2, në rreshtin e dytë dhe të tretë, atëherë i pandehuri kishte bërë ndryshimë, duke vënë në lajthitje anëtarin tjetër të komisionit Sabide Beqiri dhe i kanë rënë vijë mbi shkrim dhe më poshtë kanë vendosur përqindje të tjera, e gjithë kjo pasi që ishin ndërruar mostrat në mënyrë të kundërligjshme.

Nga Shkresa e punës së komisionit OE 1”A...”nga kjo shkresë shihet se komisioni ka vërtetuar se OE “A...” nuk i plotëson kushtet e specifikuar në tender.

Nga Raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë ... e dt 06.12.2017 më këtë vërtetohet se dy Cd, në bazë të urdhëresës së Prokurorit të shtetit janë dërguar në ekzaminim në Agjencion të Forenzikës së Kosovës. Urdhëresa nga Prokurori I shtetit I.B e dt. ... RN/I.nr ... e cila e ka urdhëruar Laboratorin e Agjencisë së Forenzikës së Kosovës që të bëjë elaborimin e video incizimeve të marra nga policia në lidhje me rastin.

Nga Njoftimi për anulimin e aktivitetit të Prokurimit nr. ... i dt.27.09.2019 vërtetohet se është anuluar ky aktivitet i prokurimit për shkak të shkeljeve që janë bërë në procedurën e prokurimit.

Pas prezentimit dhe administrimit të provave materiale, në kuptim të nenit 343 par.1 të KPPRK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me marrjen në pyetje të akuzuarit J.M, nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

I pandehuri J.M në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar: dua të theksoj se në tërësi e mbështes mbrojtjen time për atë që kam deklaruar në të gjitha fazat e procedurës, dua të shtoj se e mbështes Aktvendimin gjykatësor se Apelit të Kosovës të datës 12.12.2022, dhe e lus trupin gjyqësor që seriozisht të vlerësojë këtë aktvendim. Dua të shtoj se unë J.M, kam punuar për 15 vite

në policinë e Kosovës dhe gjatë asaj periudhe nuk kam pasur as me të voglën vërejtje apo kritikë apo ndonjë masë lidhur me punën time në Policinë e Kosovës. Sa i përket akuzës me të cilën unë akuzohem lidhur me këtë tender, dua të deklaroj që kjo ka qenë punë dytësore e imja dhe jo punë primare e imja që e kam bërë zakonisht. Sa më kujtohet atë ditë kur jam caktuar si anëtar i komisionit në këtë tender kam qenë në terren dhe me është kumtuar përmes telefoni nga mbikëqyrësi im që po të caktojnë në një komision në prokurim lidhur me një tender. Tani për momentin nuk me kujtohet a ka qenë po ajo ditë apo e nesërmja, pasi jam kthyer kam shkuar në bazë të udhëzimeve në zyrën e prokurimit të bisedoj lidhur me këtë çështje. Sa më kujtohet kam biseduar me zyrtaren S.B, dhe unë kam menduar se aty do të kryhet për një ditë apo do të jetë një kohë shumë e shkurtë. Nga zyrtarët e prokurimit kam kuptuar se kjo çështje, ky vlerësimi apo kjo punë do të zgjasë për një periudhë dy javë deri tri apo një muaj. Me këtë rast unë kam kontaktuar mbikëqyrësin tim, pasi që ishte kohë vere, kohë pushimesh muaji i 8 –të, muaji Gusht dhe nga ai mbikëqyrës kam kërkuare që brenda mundësive të ndërrohem me ndonjë zyrtarë tjetër pasi që në atë periudhë se ende nuk kisha shfrytëzuar as pushimin veror. Nga i njëjti kam marrë një konfirmim që emri im ka shkuar tek drejtori i zyrës mbështetëse që të jem anëtar dhe është problem që të ndërrohem. Andaj, kam vazhduar punën në atë komision. Krejt kjo punë e imja ka qenë për herë të parë dhe asnjëherë me herët nuk e kisha bërë një punë të tillë të marrë pjesë në prokurim. Kemi vazhduar me procedurën ashtu siç na ka udhëzuar zyrtarja e prokurimit S.B ku kjo punë ka zgjatur diku rreth 8 deri 10 ditë. Mostra më sa më kujtohet të gjitha mostrat e tenderëve në Policinë e Kosovës kishin qëndruar në një zyre të caktuar me kamera komplet për të gjithë tenderët me sa kam kuptuar. Aty kishin qëndruar dhe aty është bërë vlerësimi i të gjitha mostrave, që kishte qenë si rregull i prokurimit që aty të qëndrojnë dhe aty të vlerësojnë të shiqohen. Mirëpo pasi kishte qenë kohë vere, ka qenë nxehtë dhe aty kishte edhe zyre të tjera që shfrytëzoheshin për vlerësimin e tenderëve tjerë, zyrtarët e prokurimit kanë vendosur që ato mostra e këtij tenderi që kam qenë komisioni të vlerësohen dhe të shiqohen në një zyre tjetër, ku me këtë rast unë veten kam zbatuar urdhërat e zyrtarit të prokurimit. Mostrat kanë qenë të 8 operatorëve ekonomik, të cilët kanë aplikuar për këtë tender me sa kujtohet disa operatori ekonomike, se tenderi ka qenë në dy pjesë i ndarë, rrobat elegante verë, dimër këmisha vere - dimër, kravat dhe gjësende të rrobave, kanë qenë katër komplete të rrobave komplete, dy parë kanë qenë për verë, dy parë kanë qenë për dimër, ka pasur këmisha krevate, ku në këtë tender disa operatori ekonomik kishin aplikuar për rroba elegant si dhe me këpuce elegante verë - dimër, ndërsa disa operatori ekonomik kishin aplikuar vetëm me rroba pa këpucë. Rrobat i kemi shiquar siç e cek në atë zyre jo të kamareve por në tjetrën zyre ku rrobat kanë qenë në paketa të madhja ku bartjen e pakteve nga zyra e kamerave për tek zyrja ku i kemi shiquare apo kemi vlerësuar kryesisht e kam bërë unë në shumicën e rasteve. Dua të shtoj që aq kohë sa kam punuar aty nuk kam bërë as më të voglën shkelje apo keqpërdorim i cili më vihet në barrë. Aty kam vazhduar të punoj derisa është anuluar ky tender, ku arsyet e anulimit janë shumë të qarta ku është bërë njoftim nga ana e policisë, zyra e prokurimit për arsyet e anulimit si dhe njoftimi është në faqen e komisionit për rregullimin publik, që policia e kishte dërguar edhe policia të ky komision si dhe është cekur arsyet e anulimi këtij tenderit. Arsyje ligjore të anulimit të këtij tenderi pas përfundimit të punës si komisioni ose si anëtar i komisionit nga zyrtarët e prokurimit janë njoftuare se ka përfunduar si procedure dhe mund të vazhdosh me detyra primare tuaja. Lus nga trupi gjykues që të vlerësoj çdo rrethanë sa i përket kësaj çështjeje, për arsyeje se jam i dëmtuar në të gjitha aspekte. Sa i përket këtij tenderi që unë akuzohem nga ana e prokurorisë gjoja se kam tentuar të favorizoj një operator ekonomik kjo nuk ka ndodhur nga ana ime, deklaroj me përgjegjësi të plotë. Ku sa i përket kësaj unë kam qenë vetëm një anëtar i komisionit edhe po të doja nuk kisha mundur që të ia mundësoj një operatori ekonomik të fitoj. Dhe sa për këtë kësaj çështje ky tender është anuluar për krejt rrethana tjera ligjore. Sa i përket punës të cilës kemi bërë në atë komision aty është drejtorja e administratës e përgjithshme e policisë së Kosovës dhe çdo lëvizje çdo hyrje dalje, aty përveç që është nën monitorimin e kamerave në hyrje duhet të

hapet çdo send që ke me vete, siç janë ndonjë çantë dore ndonjë gjësende, nuk fshihet duhet të hapet dhe të shihet nga zyrtarët policor në hyrje dhe dalje në të gjitha portat e policisë së Kosovës hyrjet, daljet kontrollohen. Sa i përket kësaj çështje unë rreth një vit e gjysmë jam kontaktuar përmes telefoni nga një zyrtarë i Inspektoratit policor Kosovës, emri i të cilit nuk më kujtohet për momentin dhe më pas më kanë ftuar për një intervistë në Inspektoratin e Policisë së Kosovës.

Rrjedhimisht gjykata, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave dhe vlerësimit me ndërgjegje të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën, konform nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk ishte kontestues fakti se i pandehuri J.M ka punuar në Policinë e Kosovës, në pozitën e rreshterit në kohën kur është shpallur tender për "F..." me nr. të prokurimit ... dhe se ishte përzgjedhur si anëtar i komisionit për vlerësim të ofertuesve- Operatorëve Ekonomik të cilët kishin aplikuar për tenderin në fjalë.

Nuk ishte kontestues fakti se Operatorët Ekonomik të cilën kishin konkurruar për tenderim nuk i kanë plotësuar kushtet në bazë të specifikacioneve të mostrave , për fitim të tenderit "Furnizim me Rroba Elegante" me nr. të prokurimit ..., në bazë të vlerësimeve të cilat i kishin bërë tre anëtarët e komisionit, e ku ndër operatorët ofertues ishte i përfshirë edhe Operatori Ekonomik "A...".

Kontestues ishte fakti i ndërmarrjes së veprimeve inkriminuese në drejtim të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së nga i pandehuri J.M, ngase i njëjti mohon që në ditën kritike të i ketë ndërruar mostrat e rrobave elegante, duke vendosur mostra të tjera dhe ndryshim në specifikacione të përmbajtjes së rrobave tek fletëvlerësimet, me qëllim që të i mundësoj Operatorit Ekonomik nr. ... "A..." që të fitoj tenderin për "F..." edhe pse nuk i kishte plotësuar kushtet.

Gjykata këtë gjendje faktike e vërtetoi edhe nga dëshmia e dëshmitarës S.B e cila kishte qenë kryetare e Komisionit, e cila ka deklaruar në shqyrtim gjyqësor si dhe në deklaratat e dhëna më parë se në ditën kritike J.M e ka pasur një çantë me vete dhe gjatë orarit të pauzës i njëjti ka kërkuar që të qëndroj në zyrë, ndërsa pas orarit të pauzës pandehuri Jeton ka kërkuar nga dëshmitarja S.B që edhe një herë të rishikojnë mostrat e Operatorit Ekonomik nr... edhe pse ishte bërë nënvizimi i specifikave të tyre paraprakisht me qëllim të vlerësimit, i njëjti kishte kërkuar të rishikohen mostrat me arsyetimin se është bërë një gabim gjatë leximit. Kanë hyrë në zyrën ku ishte nën vëzhgim të kamerave. Duke i kontrolluar e ka vërejtur se përmbajtja e mostrave të rrobave ishte ndryshe dhe specifikat ishin ndryshe, në specifikat të cilat kanë qenë të paraqitura në specifikacione e ka vërejtë se nga sakoja pantollonat që ka qenë, ka qenë ndryshe përshkrimi, e njëjta duke menduar se gabimisht është shënuar 10-20 dhe veç është ndërruar e polisterit dhe viskozës ndërsa wool ka qenë mire, të cilin e ka pasur secili operator, e pastaj e njëjta duke besuar se ka gabuar, pasi që ka rënë në lajthitje nga i pandehuri Jeton, e ka përmisuar me kimik të thjeshtë, viskoza polister në përqindje dhe në përmbajtje. Sipas dëshmisë së saj përmbajtja e rrobave ka qenë wool, viskoze dhe polister, herën e parë dhe përshkrimi ka qenë 70% 10% 20% ndërsa herën e dytë e kemi regjistruar 70% 20% 10 %, sa më kujtohet leximin dhe përshkrimin e ka bërë J.M ndërsa unë kam shënuar me një letër të thjeshtë me kimik, gjithashtu edhe në herën e dytë është bërë ngjashëm. E njëjta ka theksuar se kemi qenë duke përmisuar këto të dhëna, kur ka ardhur anëtari i komisionit N.L dhe ka hyrë brenda, pasi që e ka kuptuar çfarë është bërë i njëjti edhe e ka lajmëruar Drejtorin.

Dëshmisë së dëshmitares, gjykata ia fali besimin e plotë, këto deklarime gjykata i vlerësoj si të besueshme, kjo për faktin se deklarimi i saj ka koherencë me deklaratimet tjera të cilat i ka dhëna edhe në shqyrtime të mëhershme gjyqësore, lidhur me këtë rast, e po ashtu edhe për faktin se deklarimi i saj ka lidhje logjike me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës ku nga Shkresa, Aneksi 1, Specifikimet teknike të detyrueshme është vërtetuar fakti se komisioni në përbërje të plotë, disa ditë më heret kishte konstatuar se OE "A..." nuk i plotëson specifikat teknike në pikën 2, në rreshtin e dytë dhe të tretë, ndërsa i pandehuri kishte bërë ndryshime, duke vënë në lajthitje anëtarin tjetër të komisionit S.B dhe i kanë rënë vijë mbi shkrim dhe më poshtë kanë vendosur përqindje të tjera, ku fillimisht ka qenë përmbajtja e 70%,10%, 20% , ndërsa i kanë rënë vij duke e ndryshuar përmbajtjen e specifikave në 70%, 20%, 10%, e gjithë kjo pasi që ishin ndërruar mostrat në mënyrë të kundërligjshme. Gjthashtu nga shkresa e komisionit OE 1 "A..."nga kjo shkresë shihet se komisioni paraprakisht ka bërë vlerësimin e specifikacioneve të mostrave të rrobave të OE "A..."duke konstatuar se OE "A...ka sjellur 70 % Wool, 10 % viskoz dhe 20% polyster dhe nuk plotëson specifikat teknike.

Se mostrat ishin ndërruar në mënyrë të kundërligjshme paraprakisht nga i pandehuri J.M fakt i cili shihet edhe nga në video-incizime ku i pandehuri J.M i tërheq nga zyra ku ishin të vendosura pakot me rroba të tetë operatorëve ekonomik, tërheq njërin nga pakot gjatë orarit të pauzës, përkatësisht me datë 08.08.2018 në ora 12:42 min hyn në zyrën e prokuorimit ku kanë qenë të vendosura paketat me mostra, e tërheq e dërgon diku dhe pas pak çastesh dikur rreth orës 12:43:20 të njëjtën pako e sjell në vendin ku kanë qenë më parë, pastaj e thërret tani dëshmitaren S.B për ti parë edhe një herë rrobat e A...me arsyetimin se në herën e parë kishin gabuar në lexim specifikave, e ku nga videoincizim shihet se në ora 13:28:30 në zyrën ku kanë qenë mostrat, kanë hyrë kryetarja e komisionit S.B se bashku me të pandehurin J.M.

Gjykata gjendjen faktike e vërtetoi edhe nga dëshmia e dëshmitarit N.L, i cili nuk kishte qenë i pranishëm gjatë ndryshimit të karakteristikave të rrobave por gjatë kohës sa kanë qenë S.B dhe i pandehuri J.M në zyrën ku kanë qenë mostrat e rrobave kishte shkuar aty dhe i cili kishte gjetur mostrat e rrobave në tavolinë dhe u ka thënë tani të akuzuarit dhe S.B "së cka po ndodhë aty" , si dhe i ka gjetur fletëvlerësimet e ndryshuara, e ku S.B i kishte thënë kemi bërë një gabim gjatë vlerësimit dhe situatë është tensionuar dhe u kam thënë të ndërpritet puna, aty i pandehuri Jetoni kishte reaguuar dhe duke kërkuar që të mos bëhet e madhe kjo punë. Vlen të theksohet edhe fakti se dëshmitari N.L nuk ka qenë i pranishëm gjatë ndryshimit të karakteristikave të rrobave, e që prania e tij ka qenë e detyrueshme, sepse komisioni kur kanë filluar punën, gjithnjë kishin filluar në kohë së bashku ku ishin të pranishëm të tre anëtarët e komisionit si dhe vlerësimi i kriterëve dhe specifikave të mostrave të rrobave ishte bërë paradite nga ora 11:00 - 11:30 nga tre anëtarët e komisionit, ndërsa asnjëri nga operatorët ekonomik nuk i kishin përmbushur kriteret në bazë të specifikave të mostrave për tenderin në fjalë.

Sipas dëshmitarit N.L e jashtëzakonshmja e asaj dite ishte se i pandehuri J. dhe S.B kishin filluar punën në zyrën ku gjendeshin mostrat e rrobave para se të mbledhshin të tre anëtarët bashkë, gjithashtu si e jashtëzakonshme për dëshmitarin N. kishte qenë fakti se i pandehuri J.M atë ditë kishte marrë një çantë me vete. Po ashtu duhet të theksohet fakti se dëshmitari N.L në shqyrtim gjyqësor ka thënë se i akuzuari J. e ka njoftuar se njëri nga operatorët ekonomik i ka shkuar në shtëpi dhe nga ai ka kërkuar ndryshimin e karakteristikave të rrobave me arsyetimin se ishte bërë një gabim teknik. I njëjti gjithashtu ka deklaruar se emri i operatorit të cilit i janë bërë ndryshimet nuk i është kujtuar, por fjala është për të njëjtin operator për të cilin janë prekur mostrat, e ku mostrat janë prekur tek operatorit Ekonomik "A...". I njëjti ka deklaruar se këtë proces e ka ndaluar duke kosnideruar se do të i shkaktoj dëm buxhetit të Kosovës dhe vet komisionit, duke i njoftuar eprorët lidhur me veprimet e të pandehurit J.M.

Gjykata vlerëson se kjo dëshmi gjen mbështetje në provat materiale si dhe personale e ku gjen është në përputhje edhe me dëshminë e dëshmitares S.B, sepse nga video-incizimet është

vërtetuar se tani i akuzuari J.M në orar të pauzës, përkatësisht në ora 12:42 min ka tërhequr pako me rroba dhe për pak çaste e kthen në zyrën ku ishte më parë. Pastaj kërkon nga dëshmitarja S.B të rishikohen mostrat rrobat me arsyetimin se është bërë një gabim në lexim të specifikacioneve dhe i gjen duke bërë ndryshim të specifikacioneve të mostrave, ku S.B pa qenë në dijeni, e vënë në lajthim nga i pandehuri thotë se kemi bërë një gabim tek leximi i specifikacioneve të mostrave tek një operator ekonomik në fletëvlerësimet. Ndryshime e specifikacioneve janë bërë pa prezencën e dëshmitarit N.L si anëtar i komisionit, gjë që ishte e pa zakont, sepse i pandehuri J. më parë i kishte treguar dëshmitarit N.L se një operator ekonomik kishte kërkuar ndryshimin e karakteristikave të rrobave se ishte bërë një gabim dhe në momentin kur dëshmitari N. gjen se i pandehuri është duke i bërë ndryshimet në fletëvlerësimet, kupton se mostrat janë ndryshuar në mënyrë të kundërligjshme. Andaj, gjykata dëshminë e tij e ka konsideruar në tërësi si të besueshme.

Gjykata analizoi edhe dëshminë e dëshmitarit E.H, mirëpo nuk ka arritur të vërtetoj ndonjë fakt vendimtar, ngase i njëjti ka deklaruar se në kohën e kryerjes së veprës penale kishte qenë duke e zëvendësuar drejtorin, ndërsa nuk ka marrë fare pjesë në procedura të tenderimit dhe se i njëjti ka deklaruar se nuk i kujtohet të ketë parë të pandehurin J.M të ketë qëndruar në zyrën e prokurorit në orar të pauzës.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit V.M, gjykata e konsideroi si irelevante lidhur me çështjen, ngase i njëjti është pronar i firmës “ A...” që kishte marrë pjesë si ofertues apo konkurrues në tenderin “F...”, ndërsa veprimet e ndërmarra në mënyrë të kundërligjshme nga i pandehuri J.M si anëtar i komisionit, duke ndërruar mostrat e rrobave të këtij operatori si dhe specifikacionet në përmbajtje të tyre, kanë pasur për qëllim që të i’a mundësoj operarit “A...” që të fitoj tenderin në fjalë. Nga deklarata e të njëjtit rrjedh se mostrat e rrobave i ka tërhequr pasi që është njoftuar lidhur me anulimin e tenderit.

Gjykata me kujdes të posaçëm analizoi edhe vlerësoi mbrojtjen e të pandehurit dhënë në shqyrtim gjyqësor, meqenëse i njëjti është mbrojtur në heshjte në Prokurori, mirëpo deklarimet e tij i konsideron jo bindëse bindëse për gjykatën, sepse në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor nuk pranoi të ketë ndërmarrë ndonjë veprim konkret inkriminues në drejtim të veprës penale për të cilën akuzohet, ku i njëjti ka theksuar edhe në fjalën përfundimtare se dëshmitari vet ka deklaruar se i ka dorëzuar dhe i ka tërhequr mostrat e rrobave, të cilat kanë qenë të njëjta, ashtu që ka kërkuar nga trupi gjykues që i njëjti të lirohet nga aktakuza, gjithashtu i njëjti mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor e ka arsyetuar se ka punuar për 15 vite në Policinë e Kosovës dhe se derisa ka punuar aty në atë kohë nuk ka bërë as shkeljen më të vogël apo të ketë keqpërdorur diçka, sa i përket tenderit që akuzohet, se ka tentuar të favorizojë një operator ekonomik e ka mohuar këtë gjë me pretendimin se ka qenë vetëm anëtar i komisionit, ndërsa edhe po të kishte dashur nuk do të kishte mundësi të mundësoj një operatori të fitoj dhe duke theksuar se tenderi është anuluar për rrethana tjera ligjore. Andaj, gjykata konsideron se i njëjti nuk ka arritur të ofroj asnjë provë shfajësuese, lidhur me veprimet e ndërmarra në mënyrë të kundërligjshme në drejtim të veprës penale dhe deklarimet e tij për gjykatën janë jo bindëse, nuk janë të besueshme, i njëjti ka për qëllim të i shmangët përgjegjësisë penale, ngase gjykata vetëm se e ka vërtetuar gjendjen faktike.

Gjykata po ashtu analizoi dhe vlerësoi pretendimet e mbrojtësit të pandehurit av. Shpresa Hasaj Hyseni e cila konsiston në atë se prokuroria nuk ka mundur të argumentojë dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale që i vihet në barrë për arsye se nuk ka ofruar asnjë provë konkrete dhe të besueshme për të vërtetuar ndërmarrjen e ndonjë veprimi inkriminues të pandehurit J.M e cila pretendon se me asnjë dëshmi të dëshmitarëve nuk është provuar se i

pandehuri J.M e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ngase bazuar në dëshminë e dëshmitarës- kryetarës së komisionit S.B të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, se nuk ka mundësi të ndërrohen rrobat sepse çdo gjë ka qenë nën vëzhgimin e kamerave dhe si komision kanë të drejtë 100 herë ti shiqojnë specifikat e materialet dhe mendimin përfundimtar e marrin së bashku si komision e që në këtë moment ende nuk kishin arritur në vlerësimin e tenderit por te nënvizimi i specifikave që pastaj duhet ti vendosin në vlerësimin përfundimtar dhe sigurisht edhe në tendere tjera ka pasur këso lloj gabime dhe përmisime. E njëjta është thirrur edhe në deklaratimet e dëshmitarit E.H se nuk i kujtohet se në zyrën e prokurimit ka qëndruar J.M, gjatë pauzës ditën kur pretendon se janë ndërruar mostrat e rrobave. Asnjë nga dëshmitarët nuk ka thënë që e kanë parë parë J. duke i ndërruar mostrat e rrobave të tenderit. Ndërsa sa i përket videoincizimeve i konsideron si prova të papranueshme duke pretenduar në atë se dëshmitari I.K i cili ka punuar si administrator në sistemin e kamerave të Policisë së Kosovës, nuk ka pranuar asnjë kërkesë me shkrim për nxjerrjen e video incizimeve. Gjithashtu mbrotjen e ka mbështetur në atë se nuk është shkaktuar asnjë pasojë dhe nuk ka përfituar “ A...” nga ky tender, buxheti i Republikës së Kosovës nuk është dëmtuar për asnjë moment nga askush.

Gjykata gjen se deklaratimet e mbrojtjes së pandehurit kanë për qëllim shmangien nga përgjegjësia penale, ku nuk ka arritur të argumentoj dhe as të provoj faktin se i pandehuri nuk e ka kryer veprë penale për të cilën akuzohet. Ngase pretendimi se anëtarët e komisionit kanë të drejtë të shiqojnë disa herë specifikat e materialit, nuk qëndron ngase në këtë rast i pandehuri J.. i kishte ndërruar mostrat si dhe specifikat e mostrave të cilat ishin vlerësuar më parë në fletëvlerësim, duke u rënë vij në përbindje të përmbajtjeve. Se i pandehuri J.M ka qëndruar në zyrën e prokurorit në ditën kritike në kohën e pauzës, ky fakt u vërtetua nga provat materiale dhe personale.

Sa i përket provave materiale- video incizimeve, ku mbrojtja konsideron se janë marrë në mënyrë të kundërligjshme dhe janë provë e pa pranueshme, dhe se nuk janë marrë përmes në mënyrë formale, gjykata këtë fakt e mbështeti në dëshminë e dëshmitarit B.H –zyrtar i IPK-së, në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 19, në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Inspektoratit Policor dhe Policisë së Kosovës e dt. 10.10.2016 si dhe në dëshminë e dëshmitarit I.K – si administrator i sistemit të kamerave në Policinë e Kosovës.

Nga deklarata e dëshmitarit B.H vërtetohet fakti se incizimet janë marrë nga hetuesia e policisë duke u mbështetur në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 19, ku pika 7 përcakton se : *“IPK ka të drejtë të kontrolloj, konfiskoj, analizoj dhe të mbaj dokumente, dëshmi dhe informacione në formë të shkruar ose elektronike në të gjitha zyrat e, sekretariat arkivat apo çfardo burimi tjetër i informacionit në pajtim me ligjin në fuqi.”* pasi janë pranuar incizimet nga policia sipas Urdhresës së Prokurorit të shtetit I.B, me nr. RN.I.nr ... i kemi dërguar në Agjencion të Forenzikës të Kosovës , ku parashihen edhe kompetencat e IPK-së dhe policisë në marrjen e provave duke përfshirë edhe video-incizimet në objektet publike për punë zyrtare.Pastaj në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes IPK-së dhe Policisë të dt. 10.10.2016 parashihet se IPK-së i lejohej të ketë qasje në të gjitha dokumentet , objektet dhe arkivat e Policisë së Kosovës.

Se video incizimet janë marrë në mënyrë formale dhe në formë të shkruar, vërtetohet nga Korrespondencat Email-at e Majorit G.F në lidhje me video materialet nga sektori i IT-së dorëzuar IKP-së, dhe nga dëshmia e dëshmitarit I.K – si administrator i sistemit të kamerave të Policisë së Kosovës vërtetohet fakti se i njëjti ka qenë në “CC në email” kur janë kërkuare video incizimet dikun rreth datës 11.08.2017, duke theksuar në këtë rast ne nuk kemi pasur kërkesë eksplicite te drejtpërdrejt për nxjerrjen e video incizimeve, lidhur me kërkesën e parashtruar nga major G.F, por për marrjen e videoincizimeve kanë qenë të njoftuar eprorët tonë, e ku në bazë të emailit shihet se major G.F, ka pasur komunikim me hetuesin e IPK-së B.H, në një korrespondencë me date 09.10.2017, G.F i është drejtuar përmes korrespondencës hetuesit të IPK-

së B.H , drejtori ketë e ka përcjell tek shefi i sektorit të IT në atë kohë i cili ka qenë F.R , shefi i sektorit këtë kërkesë e ka përcjellur tek ish kolegu – K.Ç i cili e ka realizuar kërkesën.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave të rëndësishme, bazuar në faktet dhe provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, deklaratave të dëshmitarëve vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm dhe gjeti se në veprimet e të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, në kohë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, ngase i pandehuri me veprimet e tij të manifestuara me dashje direkte hyn në zyrën prokurorimit në kohën e pauzës ku gjenden mostrat e tenderit, bën ndërrimin e mostrave të Rrobave Elegante të Operatorit Ekonomik “A...” në mënyrë të kundërligjshme me qëllim që të i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror Operatorit Ekonomik “A...” në fitimin e tenderit “F...” në shumë prej 506.216.20 Euro. Dëmi nuk është shkaktuar, mirëpo i njëjtji duke vepruar si Person Zyrtar, veprimet i ka ndërmarr nga shfrytëzimi apo tejkalimi i detyrës zyrtare apo autorizimit zyrtar, me qëllim të realizimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për personin tjetër, në këtë rast për operatorin Ekonomik “A...”. Andaj, gjykata e gjeti se në aspektin penalo juridik është penalisht përgjegjës dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paparë ligjor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari nuk ka qenë më parë i dënuar, ndërsa gjykata si rrethanë rënduese mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale. Meqenëse kjo vepër penale bën pjesë në kapitullin e XXXIII të veprave penale “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare” duke pasur parasysh se veprimet e të akuzuarit përbëjnë sjellje të kundërligjshme të drejtuara kundër funksionimit të rregullt të shërbimeve publike, të cilat i ka kryer në cilësi të personit zyrtar, përmes shfrytëzimit të palejshëm të pozitës dhe të autorizimeve zyrtare që i gëzon gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe një person të këtillë e detyrojnë të ketë vigjilencë të shtuar për veprimin e ligjshëm, për shfrytëzim të ligjshëm, të drejtave dhe autorizimeve të tij, kjo kategori e kriminalitetit karakterizohet me shkallë të lartë të rrezikut për shoqërinë e sidomos në çrregullimin e funksionimit të shërbimeve publike dhe institucioneve shtetërore. Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është adekuat dhe në përputhshmëri me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, me bindje se një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë në kryerjen e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Konform nenit 59 par.1, nën par.2, pika 2.3 të KPRK-së gjykata vendosi lidhur me dënimin plotësues.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 452, par. 1, të KPRK-së ndërsa lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 36 par 3, pika 3.2, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin (Ligji nr. 08/L-109).

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
- Departamenti i Krimeve të Rënda -
PKR. nr. 98/23 i dt.01.03.2024

B. Profesionale
Qëndresa Alimehaj- Ujkani

Kryetarja e trupit gjykues –gjyqtarja
Alltën Murseli

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.